



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 570, datë 6.10.2021

P Ë R

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1134, DATË 24.12.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT
TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT/RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE,
NË BASHKINË TIRANË DHE CAKTIMIN E BASHKISË TIRANË
SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në shkronjën “b”, të pikës 1, të vendimit nr.1134, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, emërtimi “... TIP në RSU nr.1 (nr.16) ...” zëvendësohet me “... TIP në RSU nr.1 (nr.19) ...”.

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTEJIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 4676/1
DATE 7.10. 2021

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTRIT
TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN
E REFORMAVE
BASHKISË TIRANË
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

